



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

### EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 29 dhjetor 2015, në mbledhjen e XXIII-të  
(njëzetetretë) të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 13.05'.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Mehmet Gashi, kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti: Bahri Blakçori, Islam Revuçi, Fidan Rekaliu, Haki Rudari, Kadri Avdiu, Kumrie Hoti, Mynavere Abdullahau – Krasniqi, Naim Çunaku, ndërsa mungoi Rafet Llapashtica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Agron Hyseni, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Agron Gërguri, u.d. i drejtorit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Muharrem Haziri, OSBE.

#### 1. Miratimi i rendit të ditës

**z. Agron Hyseni**, theksoi, kohëve të fundit kemi presion prej një numri shumë të madh të familjeve të cilat nuk kanë pasë mundësi financiare për sigurimin e druve për ngrohje, por e njëjta kërkesë është edhe nga Qendra Për punë Sociale dhe në bazë të këtyre kërkesave e kam parë të arsyeshme që të kërkoj nga ky Komitet të na mbështes për shqyrtimin e mundësive për ofrimin e ndihmës së cekur, ngase në gjendje tejet të rëndë sociale janë së paku 450 familje dhe për shkolla të cilat kanë nevojë shtesë për dru për ngrohje.

**z. Fidan Rekaliu**, theksoi, sa i përket çështjes të cilën e ngriti parafolësi, këtë e kemi biseduar me Kryetarin e Komunës pas një takimi me kryesuesin e Kuvendit që e kemi mbajtur me shefat e Grupeve të këshilltarëve të Kuvendit, dhe të gjithë jemi pajtuar që një pjesë e sasisë së druve të konfiskuara për shkak të prerjes ilegale t'iu shpërndahet familjeve me gjendje të rëndë sociale dhe shkollave të cilat kanë nevojë për dru shtesë për ngrohje.

**Kryesuesi z. Mehmet Gashi**, theksoi, në takimin e cekur nga parafolësi çështjen e propozuar e ka mbështetur edhe z. Rafet Llapashica, shef i Grupit të këshilltarëve të PDK –së, ;por i njëjti ka paralajmëruar se do të mungoj në këtë mbledhje.

**z. Haki Rudari**, theksoi, në takimin e cekur kam qenë i pranishëm edhe unë dhe çështjen e propozuar e kam mbështetur në parim, për këtë kam pyetur në strukturat përkatëse të subjektit tim politik dhe më kanë thënë se nuk është i bazuar në ligj, andaj kisha dëshiruar sqarime shtesë nga Zyra Ligjore rreth ligjshmërisë së një vendimi të këtillë.

*Rendi i propozuar i ditës u miratua njëzëri së bashku me propozimin e z. Agron Hyseni, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, që në rend dite të përfshihet edhe:*

- **Shqyrtimi i mundësive për furnizim me dru zjarri për familjet me gjendje të rënd sociale dhe të disa shkollave**

## **2. Shqyrtimi i Ekstraktit të procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa më 24 nëntor 2015**

*Ekstrakti i procesverbalit u miratua njëzëri.*

## **3. Propozimi i vendimeve për mbrojtjen e vlerës së natyrës si monument i natyrës:**

- **Trungu i shpardhit ( Quercus frainetto ) - Dyz**
- **Trungjet e dushkut ( Quercus sp. ) – Llapashticë e Epërme**
- **Trungu i dushkut ( Quercus sp. ) – Llapashticë e Epërme**
- **Vrella dhe trungu i ahut ( Fagus sp. ) – Dobratin**
- **Trungu i plepit ( Populus tremula ) – Murgullë**
- **Trungu i plepit ( Populus tremula ) – Gërdoc**
- **Trungu i plepit ( Populus tremula ) – Orllan**

**z. Durim Salihu**, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, e paraqiti fjalën hyrëse.

**z. Mynavere Abdullahu – Krasniqi**, theksoi, Mbështes propozim vendimin për mbrojtjen e këtyre monumenteve natyrore, duke pas parasysh se këto monumente natyrore për Komunën tonë janë me rëndësi të shumëfishtë, si në edukim, shkencë, kulturë, turizëm. Andaj është e domosdoshme mbrojtja e tyre.

**z. Kumrie Hoti**, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve të PDK – së, plotësisht e mbështesim propozimin për vënie në mbrojtje të vlerave përkatëse natyrore dhe rekomandojmë që kjo çështje të miratohet në Kuvendin e Komunës.

**z. Haki Rudari**, theksoi, propozimi për të cilin po debatojmë ndërlidhet me Ligjin për mbrojtjen e natyrës dhe propozoj që jo vetëm formalisht të vihen nën mbrojtje por që pas miratimit Ekzekutivi i Komunës në mënyrë permanente të kujdeset për mbrojtjen e vlerave të cekura natyrore.

**z. Kadri Avdiu**, theksoi, pajtohem plotësisht me propozimet e paraqitura, por unë jam i interesuar të di se përveç vlerave natyrore të propozuara, a ka edhe vlera të tjera natyrore të cilat duhet të vihen nën mbrojtje, këtë pyetje e shtroj ngase jam në

dijeni se ka edhe vlera të tjera të kësaj natyre, shembull një dru qarri shumë i vjetër në afërsi ku kufizohen fshatrat Dyz dhe Koliq

**z. Durim Salihu**, theksoi, pyetja e parafolësit është plotësisht e qëndrueshme ngase ka edhe vlera të tjera natyrore të cilat duhet të vihen nën mbrojtje, mirëpo Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor është në procedurë e sipër përkatësisht është duke i vlerësuar edhe disa vlera të tjera natyrore për të cilat së shpejti do të paraqes propozimet konkrete.

*Pas votimit u konstatua se Kuvendit, njëzëri i rekomandohet për shqyrtim.*

#### **4. Draft Plani Lokal i Veprimit për Riintegrim në Komunën e Podujevës**

*Nuk pati diskutime dhe pas votimit u konstatua se Kuvendit, njëzëri i rekomandohet për shqyrtim.*

#### **5. Propozimi i Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2016**

**Kryesuesi z. Mehmet Gashi**, e paraqiti fjalën hyrëse.

**z. Kumrie Hoti**, theksoi, Plani i punës së Kuvendit është i mirëseardhur për mbarëvajtjen e punëve vjetore të Kuvendit të Komunës, mirëpo konsideroj se në këtë plan pune do duhej të përfshihet edhe: Informata nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, rreth gjendjes së përgjithshme të Shëndetësisë në Komunën e Podujevës, e cila do të shqyrtohej para rishikimit të buxhetit komunal për vitin 2016, në mënyrë që të shqyrtohen nevojat për rialokim të mjeteve buxhetore të nevojshme për pjesën e dytë të vitit 2016.

**z. Fidan Rekalii**, theksoi, lidhur me propozimin e Planit të punës së Kuvendit, shefat e Grupeve të këshilltarëve kemi mbajtur një takim të udhëhequr nga kryesuesi i Kuvendit në të cilin në mënyrë unanime jemi pajtuar me të gjitha propozimet përkatësisht pikat e rendit të ditës të cilat do të shqyrtohen në mbledhjet e Kuvendit në vitin 2016, por e mbështesim edhe pikën e propozuar nga parafolësja dhe jemi të hapur dhe do të mbështesim edhe çështje të tjera të cilat do të propozohen për shqyrtim në Kuvend.

**z. Haki Rudari**, theksoi, ideja e kryesuesit të Kuvendit dhe ne të gjithëve për miratimin e Planit të punës së Kuvendit është pozitive dhe duhet të mbështetet, në parim jemi për këtë Plan të punës por kjo nuk do të thotë se është përfundimtar, pra mund të ketë ide e propozime të tjera e kjo është e përcaktuar edhe me Rregulloren e punës së Kuvendit dhe me dispozita ligjore.

Është e vërtetë se unë i kam dhënë tri propozime që të inkorporohen në këtë dokument por sipas mendimit tim ka mbet edhe një çështje pa u përfshirë e ajo është:

- Informata nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit rreth subvencioneve në lëmin e sportit në përgjithësi.

**z. Kadri Avdiu**, theksoi, për të gjithë ne është e qartë se edhe pas miratimit të këtij Plani, në Kuvend sipas nevojës në propozim të Ekzekutivit ose të këshilltarëve të Kuvendit mund të shqyrtohen edhe çështje të tjera, pra kjo mundësi është e hapur. Çështjet e parapara për shqyrtim sipas këtij dokumenti po e zëmë nëse është paraparë për janar, nëse për arsye të ndryshme nuk përgatiten për kohën e caktuar eventualisht mund të shtyhen për muajin vijues, por jo më tutje.

**z. Naim Çunaku**, theksoi, jam i mendimit se miratimi i Planit të punës së Kuvendit është një praktikë e mirë, mirëpo nuk duhet pretenduar se me këtë Plan mbyllen temat të cilat duhet të diskutohen në Kuvendin e Komunës ngase jemi në dijeni se me Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale dhe me Rregulloren e punës së Kuvendit është e drejtë e çdo këshilltari që të propozoj për shqyrtim çdo çështje për shqyrtim për të cilën ai konsideron se është në interes për Komunën, me kusht që propozimi përkatës të mbështetet nga Kuvendi.

Sa i përket afateve te Drejtoria e Arsimit kemi periudha të caktuara kur fillon dhe mbaron një çështje e caktuar, por te Drejtoritë e tjera nuk jam në dijeni se cila pikë orientuese duhet të merret për të caktuar kohën për shqyrtim të çështjeve konkrete, përkatësisht të merret gjashtëmujori i parë apo gjashtëmujori i dytë i vitit.

**z. Mynavere Abdullahu – Krasniqi**, theksoi, neni 2 i propozim Vendimit për miratimin e Planit të punës së Kuvendit, në mënyrë të qartë përcakton se Kuvendi, përveç çështjeve të parapara, mund të mbajë edhe mbledhje të rregullta ose të jashtëzakonshme dhe të shqyrtoj çështje të cilat i propozohen për shqyrtim.

**z. Agron Gërguri**, u.d. drejtor i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, theksoi, Kuvendi me vendim e ka themeluar Teatrin publik të qytetit “ Avdush Hasani “ por edhe pse sipas dispozitave ligjore jemi të obliguar ende nuk është caktuar buxheti për atë institucion.

Është kërkesë imediate dhe në plan të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit që çështja e trashëgimisë të jetë në radhë të parë, në këtë kontest ne kemi biseduar që Komuna e Podujevës duhet ta ketë një Muze të trashëgimisë kulturore por ka edhe çështje të tjera me interes mjaftë të madh.

**Kryesuesi z. Mehmet Gashi**, theksoi, në takimin e mbajtur me shefat e grupeve të këshilltarëve i kemi shqyrtuar propozimet e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, pajtohem se janë çështje me interes, por të njëjtat nuk janë përfshirë në këtë plan për shkak të implikimit buxhetor, mirëpo ato çështje do të shqyrtohen në ndërkohë, por mbetet obligim i Drejtorisë përkatëse që të përcaktoj implikimet e përafërta buxhetore për çështjet e propozuara.

**z. Agron Hyseni**, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, sa i përket informatës rreth gjendjes së përgjithshme të shëndetësisë, për shkak të dinamikës së shpenzimeve buxhetore jam i mendimit se kjo informatë më së miri do të ishte të shqyrtohej në muajin korrik.

*Pas votimit u konstatua se Kuvendit njëzëri i rekomandohet për shqyrtim, me plotësim me dy pika shtesë, përkatësisht:*

*1. Informatë e Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, për subvencionet e ndara klubeve sportive në vitin 2015, muaji mars.*

*2. Informatë nga Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, rreth gjendjes së përgjithshme të Shëndetësisë në Komunën e Podujevës, muaji korrik.*

## **6. Shqyrtimi i mundësive për furnizim me dru zjarri për familjet me gjendje të rënd sociale dhe të disa shkollave**

**Kryesuesi z. Mehmet Gashi**, theksoi, në fjalën hyrëse z. Agron Hyseni, në mënyrë të qartë e arsyetoi nevojën për ofrimin e ndihmës në dru për ngrohje familjeve me gjendje të rëndë sociale dhe shtoi, procedurat rreth çështjes së druve të konfiskuara për shkak të prerjeve ilegale janë të qarta por kërkojnë edhe

një kohë për zbatimin e tyre, mirëpo për shkak të nevojave të domosdoshme të familjeve me gjendje të rëndë sociale, konsideroj se do duhej shqyrtuar këtë çështje dhe të miratojmë një rekomandim Ekzekutivit të zbatoj procedura më të shkurta. e them rekomandim ngase nuk mundemi të marrim vendim.

**z. Faik Gashi**, shef i Zyrës Ligjore, lidhur me kërkesën e z. Haki Rudarit, theksoi, një pyetje të këtillë nuk e kam pritur ngase në takimin e shefave të Grupeve të këshilltarëve të subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvend të mbajtur në Zyrën e kryesuesit të Kuvendit, çështja për të cilën po debatohet është sqaruar në detaje dhe ka qenë e qartë për të gjithë të pranishmit dhe shtoi nuk ka nevojë që për çfarëdo çështjeje të pyetet askush ngase për këtë është Zyra Ligjore apo së pari mendimi do duhej të merret në këtë Zyrë.

**z. Haki Rudari**, theksoi, është çështje e imja personale ku dhe me kënd konsultohem dhe askush nuk mund të më referoj se kujt i drejtohem për konsulta.

**Kryesuesi z. Mehmet Gashi**, theksoi, në takimin me shefat e Grupeve të këshilltarëve jemi pajtuar të gjithë që në Komitetin për Politikë dhe Financa të miratojmë një rekomandim, ndërsa Ekzekutivi të zhvilloj procedurat tjera.

Në atë takim, z. Rafet Llapashtica ka informuar se nuk do të jetë i pranishëm në këtë mbledhje por do të lë porosinë që kjo çështje të mbështetet.

**z. Naim Çunaku**, theksoi, për masën drusore të konfiskuar për shkak të prerjes në kundërshtim me dispozita ligjore, unë nuk e kam të qartë se kërkesa a ishte që për këtë çështje të merr vendim Komiteti për Politikë dhe Financa apo Kuvendi. Gjithashtu nuk u përmend se çfarë mase drusore është e konfiskuar dhe propozohet që të shpërndahet.

Jam i mendimit se nëse nuk bëjmë ndonjë shkelje ligjore, në vend se të dëmtohen apo të shiten me një çmim të them qesharak, do të ishte mirë që ajo masë drusore t'iu shpërndahet familjeve në nevojë përkatësisht në gjendje të rëndë sociale.

**Kryesuesi z. Mehmet Gashi**, theksoi, për këtë çështje jemi pajtuar që të shqyrtohet vetëm në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe nëse mbështetet të miratohet një rekomandim e jo vendim.

**Agron Hyseni**, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, theksoi, arsyeshmëria për shpërndarjen e druve të cekura është shumë e madhe duke u bazuar në atë se muajin e kaluar kemi pasë rreth 1040 familje në asistencë sociale, familje të cilat të hyrat mujore i kanë prej 55 € deri në 85 € dhe ata njerëz presin mbështetjen e Juaj ngase nuk kanë mundësi me i siguruar drutë për ngrohje, pra paramendojeni se a mund ndokush t'i siguroj 10 metra dru me të hyrat e cekura.

Ato familje janë drejtuar tek unë e unë tek Ju, andaj nëse ekziston mundësia sado e vogël me i mbështet unë them se është nderë shumë i madh me i ndihmuar ato familje, por kisha shtuar edhe këtë se sasia e druve është tepër e vogël në krahasim me nevojat mjaftë të mëdha.

**z. Kadri Avdiu**, theksoi, jam i bindur se askush nuk është kundër kësaj iniciative dhe shtoi, në takimin e shefave të Grupeve të këshilltarëve z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës e sqaroi arsyeshmërinë për shpërndarjen e druve të konfiskuara dhe tregoi se sipas dispozitave ligjore, përmes ankandit, mund të shiten e me këtë do t'i krijonte të hyra Komunës, por duke u bazuar në gjendjen e rëndë të shumë

familjeve shprehu gatishmëri që drutë përkatëse t'ua ndajë familjeve në nevojë. Gjithashtu u bisedua edhe për aspektin ligjor dhe të gjithë të pranishmit u pajtuam me propozimin e Kryetarit.

Kohë më parë kam kaluar pranë vendit ku janë të grumbulluara drutë e konfiskuara dhe çuditë se si mund të lihen në atë gjendje që natyrshëm do të shkatërrohen dhe kalben.

Ne tani mund të bisedojmë për sasinë e cila do të shpërndahen, për rastet sociale konsideroj se nuk kemi çfarë të diskutojmë, ndërsa sa i përket shkollave për këtë mund të diskutojmë ngase shkollat e kanë buxhetin e vet dhe mund të sigurojnë lëndët djegëse.

**z. Kumrie Hoti**, theksoi, çështja për të cilën jemi duke debatuar është shumë e ndjeshme dhe nuk mund të vjen në pyetje të kundërshtohet dhe shpresoj se me këtë veprim sado pak në këtë dimër do të ndihmohen familjet përkatëse, ngase kjo është më e pakta që mund të bëjmë për atë kategori të qytetarëve.

E mbështes parafolësin se për familjet me gjendje të rëndë sociale nuk kemi çfarë të bisedojmë, ndërsa për shkolla kjo është çështje për të cilën mundemi të diskutojmë.

**z. Haki Rudari**, theksoi, realisht askush nuk është kundër, edhe në takimin me shefat e Grupeve të këshilltarëve në të cilin erdhi Kryetari i Komunës kam kërkuar sqarime nën 1) që nuk u dhanë si dhe nën 2) jam për shpërndarjen e druve nëse nuk bëhet shkelje ligjore. Atë ditë është biseduar që për shpërndarje të formohet një Komision nga Kuvendi i Komunës, me çka është pajtuar edhe Kryetari i Komunës.

Sa i përket shpërndarjes së druve në disa shkolla nuk pajtohem ngase për këtë është paraparë buxheti dhe ka qenë i publikuar tenderi për furnizim me lëndë djegëse për shkolla.

Konsideroj se drutë në dispozicion do duhej t'iu ndahen vetëm familjeve në nevojë, kur dihet se është edhe Lagjja e Dëshmorëve ku kanë shumë nevojë për dru për ngrohje.

**Kryesuesi z. Mehmet Gashi**, theksoi, Komiteti për Politikë dhe Financa mund të merr vendime vetëm për çështjet për të cilat e autorizon Kuvendi, përndryshe ky Komitetet mund të marrë vetëm rekomandime si në rastin konkret që mund të mbështetet në një rekomandim dhe i njëjti t'i dërgohet Ekzekutivit të Komunës.

**z. Naim Çunaku**, theksoi, nëse themi se ky Komitet nuk ka të drejtë me marrë vendime atëherë ne biemi ndesh me disa vendime që i ka marrë ky Komitet. Nëse ne nuk kemi të drejtë me marrë vendim për çështjen konkrete, atëherë këtë çështje e përcjellim në Kuvend.

**z. Faik Gashi**, theksoi, në mënyrë absolute jo ky Komitet por asnjë komitet nuk e ka të drejtën e marrjes së vendimeve, përveç rasteve kur për çështje të caktuara Kuvendi ia delegon kompetencën.

**z. Naim Çunaku**, theksoi, për këtë çështje është dashtë të bëhen konsultime paraprake e jo këtu të debatohet në mënyrë të hapur ngase në bazë të rekomandimit Drejtoria përkatëse nuk mund të bëjë shpërndarjen e druve kur dihet se rekomandimi nuk është i obligueshëm, andaj nëse jemi për shpërndarjen e druve duhet gjithsesi të merret një vendim, përndryshe nuk do të bëjmë asgjë.

**Kryesuesi z. Mehmet Gashi**, theksoi, është e vërtetë se ky Komitet ka marrë vendime por ato vendime janë marrë në bazë të autorizimit të përcaktuar me

Rregulloren për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transferte.

Pas votimit u konstatua se me shumicë votash përkatësisht 9 vota për, asnjë kundër dhe 1 votë të përmbajtur u miratua ky:

## **REKOMANDIM**

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtoria e Arsimit, të bashkërendojnë aktivitetet për furnizim me dru zjarri, nga drutë e konfiskuara të prera pa leje, si vijon:

- Familjeve me gjendje të rëndë sociale, t'iu ndahen 250 m<sup>2</sup>, përkatësisht 125 familjeve me gjendjen më ekstreme sociale t'iu ndahen nga 2 m<sup>2</sup> të druve të zjarrit.
- Sipas vlerësimit të drejtorisë së Arsimit, masa drusore prej 179 m<sup>2</sup> të shpërndahet në disa shkolla në territorin e Komunës sipas nevojës.
- Për rastet e familjeve me gjendje të rëndë sociale përfituesit i cakton Qendra për Punë Sociale.
- Drejtoria Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural sipas regjistrit të Drejtorive përkatëse e bënë shpërndarjen e druve të zjarrit.

**Mbledhja përfundoi në orën 14.00'**

**Procesverbalin e mbajti  
Faik Gashi**

**Nr. 01- 006-107437  
Podujevë,  
29 dhjetor 2015**

**Kryesuesi i Komitetit  
Mehmet Gashi**